



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. , datë 12.12.2019 të Bordit të Administrimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall konkursin publik për Administrator të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, si më poshtë:

I. KANDIDATËT PËR ADMINISTRATOR TË INSITUTIT TË GJEOSHKENCAVE, ENERGISË, UJIT DHE MJEDISIT DUHET TË PLOTËSOJNË KËTO KRITERE:

- a) Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku 5 (pesë) vjet në këto fusha;
- b) Të zotërojë gjuhën angleze, një gjuhë e dytë e Komunitetit Evropian përbën avantazh.

II. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR ADMINISTRATOR I IGJEUM

Nuk mund të kandidojnë për Adminstrator të Njësisë, kandidatët që

- a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
- b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
- d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar.
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetë deklarin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **25.12.2019** pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.